



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/379

Datë: 07.10.2020

Procesverbal

i mbledhjes së VII (shtatë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa  
REND I DITES

1. Shqyrtimi i dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -V- dhe mbledhjes së -VI- të KPF-së.
2. Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Qershor për vitin 2020.
4. Shqyrtimi i Raporti të Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2020.
5. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/869 datë:04.9.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e “Kullës së Ramadan Shabanit” në Kijevë.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.
8. Shqyrtimi i kërkesave.
9. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 16.09.2020 duke filluar në ora 13:40, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim, drejtori i drejtorisë për Financa, drejtori i drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes po ju informoj se Filloreta Bytyçi mungon në këtë mbledhje, materialin e keni marrë me kohë, buxhetin s’kemi mund të ju sjellim me kohë deri sa e kanë përgatitur drejtoria. Kush jeni për këtë rend të ditës?

Nga 5 të anëtarë të pranishëm unanimisht ishin.

1. Shqyrtimi i dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -V- dhe mbledhjes së -VI- të KPF-së.

Rrahim Morina: Kush jeni për miratim të këtyre dy procesverbaleve? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit për vitin 2021.

Valon Mazreku: Në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë jemi të obliguar që në MEF ta dërgojmë buxhetin e miratuar deri me datën 1 Tetor. MEF na kanë lajmëruar se për vitin 2021 kemi shkurtime buxhetore, shkurtime buxhetore janë në grantin e përgjithshëm dhe në të hyrat vetanake. Po ashtu shkurtime ka pasur edhe në Kash në projeksionet 2021-2023, në kategoritë ekonomike brenda buxhetit nuk është aprovuar asnjë numër i ri për staf të punëtorëve nga komisioni që ka qenë në nivel qendror. Ndryshim me i madh është të subvencionet, por që vitin e kaluar ka qenë një pa barazi sidomos të personat fizik dhe juridik, në kapitale ka qenë nivel më i lartë në qarkoren buxhetore 2, tani janë zvogëluar. Në buxhet janë paraqitur programet dhe

nënprogramet sipas draft buxhetit të shpërndarë dhe janë paraqitur sipas planifikimeve, në shëndetësinë primare janë pagat dhe shtesat te buxheti janë tri grante; ai i përgjithshëm, granti i shëndetësisë dhe i Arsimit. Te investimet kapitale 4.153,031 euro, te kanalizimet e kemi rritur vlerën në 18 mijë euro, por i kemi shkurtuar metrat, kemi menduar që në disa fshatra te parashihen parqe si në Drenovc, Carrallukë, Banjë, Astrazup etj.

Alban Krasniqi: Vitin e kaluar në Carrallukë kanë qenë të planifikuara 10 mije euro për park tani prapë keni paraparë mjete pse kështu.

Valon Krasniqi: Shihet se disa nga projektet e vitit 2020 i paski hjekë, por nuk keni me mujte mi hjekë.

Valon Mazreku: Te ndriçimi ka nevojë edhe mirëmbajtja, pastaj te renovimi i rrugëve lokale qe kemi një kontratë prej 120 mijë euro me çmim për njësi, po ashtu për kolektor te fshati Bubel qe del kemi paraparë mjete, po ashtu është paraparë edhe ndriçim publik.

Në projektet e vitit 2020 e pa bugjetuar është rruga për në Kijevë dhe rruga prej rrethit për Prishtinë, është paraparë edhe rregullimi i lumit Mirusha, ujësjellësi në fshatin Astrazup. Në kategorinë e subvencioneve kemi ndarë 200 mijë euro, pastaj për infrastrukturë në Malishevë janë paraparë 700 mijë euro, po ashtu edhe rregullimi i urës qe qon në fshatin Mirushë. Asfaltimi i rrugëve dhe trotualet pak janë reduktuar e çmimin për trotuar kemi menduar 12.70 për metër katror, po ashtu është futur renovimi i sallave të sportit dhe shtëpia “ Tahir Sinani” Në shëndetësi ka rritje te buxhetit, tani aty kemi ndërtuar edhe objektin e urgjencës aty tani ka nevojë për paisje dhe shtretër, garazh për automjete në QKMF, blerje të automjeteve, renovim të fushave sportive, renovimi i AMF në fshatin Llapçevë.

Alban Krasniqi: Çdo gjë kërkoj qe të specifikohet në buxhet të dihet saktë ku kanë me shkuar mjetet.

Valon Krasniqi: Shihet se janë larguar disa projekte si trotuar por tani janë rrjetet sociale dhe qytetaret po shohin se ku ka mu punuar dhe e dinë ato cilat janë të votuara. Pse i keni largu disa projekte si rrugët me kubëza.

Alban Krasniqi: Dallimi mes pushtuesit dhe institucionit që del prej zgjedhjeve duhet sjellja me kanë se pari, nga prezantimi i juaj drejtor kuptuam se disa projekte nuk janë realizuar dhe nuk do të realizohen pasi qe mbi 1 milion kanë shkuar në suficit. Në Kijevë i keni nisë dy fusha për t'i ndërtuar pasi që në gjirin e juaj partiak ka ardhur një asamblist, por kjo qasje kështu a bërë veç ne kohën e Serbisë, e nipit të Dëshmorit ja mohoni me ecë në asfalt se mungon qasja humaniste e ndryshe kuptohet qasje lokaliste. 700 mijë euro i keni nda për Malishevë në rrugë e në anën tjetër diskriminoni të tjerët, e unë nuk vuaj prej klientelizimit të votës. A keni futur mjete për nënat me fëmijë të porsalindur, andaj për mbledhje kërkojmë ,

Specifikacion lidhur me ndarjen e subvencioneve, Shërbimet kontraktuese tjera, cila është shuma e paraparë dhe destinimi i tyre. Cilat janë në realizim e sipër dhe cilat kanë mbetur pa u realizuar në vitin 2020, lista e borxheve dhe lista e kontratave.

Për sallën e Kuvendit të Komunës a keni paraparë diçka për këto karrigat që janë hjekë nga salla dhe pse projektet e vitit 2020 nuk janë bartur në vitin 2021.

Halil Morina: Aj që fiton zgjedhjet ka të drejtën me propozuar buxhetin, por e vetmja luftë me shty projektet përpara është lufta politike pretendimet tjera janë dashakeqe. Nëse keni vërejtje duhet t'i orientojmë dhe të inkorporojmë në buxhet por kemi kohë deri në mbledhje.

Cilat projekte janë realizuar në vitin 2019-2020.

Hashim Vrezezi: Draftin e buxhetit e kemi marrë me vonesë qëllimshëm për këtë vit, spe kuptoj pse asfaltim keni parapa 7 euro e për kanalizime 12 euro, a keni bashkëpunuar me neve për këtë buxhet, neve nuk na keni konsultuar. Buxheti është i mangët i koklavitur se nuk banë buxheti kështu me kanë. I kemi pas futur në buxhet projektet e bujqësisë si rrugët bujqësore që kanë kosto të vogël, traktorët e paraparë nuk janë futur, pastaj serat i keni planifikuar mi nda në Vjeshtë. Kjo qeverisje

veç me spërkatje keni mbajtur elektoratin sepse s'keni plan, ka shkolla që s'janë tenderuar me kohë pse po përsëriten dhe me gabime. Duhet të kemi listën e kontratave të projekteve.

Çështja e ujit shumë vende kanë problem me ujin e pijes ky problem duhet mu zgjidhë, a ka adresuar Komuna e Malishevës problemin rreth ujit të pijshëm në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ka rrugë që janë hequr e që kanë qenë të buxhetuara, pastaj ka rrugë që janë shtruar në pronë private e qytetarët nuk e kanë ditë. Te kanalizimet nuk bën mi hjekë as një metër, pra ta bëjmë një buxhet për të gjithë e jo për interesa politike, qeveria duhet me ba propozime profesionale.

Raimonda Krasniqi: Projektet e miratuar në vitin 2019 janë devijuar, janë hequr ku keni marrë guximin mi hjekë rrugët me kubëza, pastaj sa mjete kanë shkuar për vendime Gjyqësore. Të shëndetësia a keni paraparë ndërtimin e shtëpisë së shëndetit në fshatin Terpezë, ku janë ato mjete sepse keni rinovuar po s'është ndërtuar.

Rahim Morina: Në buxhetin e vitit 2019-2020 janë futur projekte pa mbulesë e shumë kanë mbetur, mbi 1 milion ka shkuar në suficit. Duhet të ulemi pozitë dhe opozitë të fusim projektet e pa përfunduara të vitit 2019, 2020, kanalizimet mos të hiqen ku kanë qenë të parapara.

Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

### 3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Qershor për vitin 2020.

Hafir Rexha: Drejtoria që udhëheq unë kemi përgatitur raportin 6 mujorë të këtij viti, gjatë kësaj kohë janë kryer punët konform Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative. Në raport i keni objektivat, sfidat, punët e sektorit për alarmim, sektori i preventives së zjarreve. Sfidë janë mungesa e personelit, gjatë kohës së pandemisë ju kemi dalë në ndihmë qytetarëve aty ku kanë pas nevojë, është bërë dezinfektimi nëpër shtëpi, abollanta, pastaj ju kemi dalë në ndihmë familjeve që kanë pas nevojë edhe për ushqim.

Alban Krasniqi: Te personeli të kemi listën e punëtorëve, profesionet e tyre si dhe pozitën e zbrazëta. Ti dimë gjithë ato pika të rëndësishme për juve, nëse ka pas shembje dheu, shtylla të rrezuara, rrezikshmëri për qytetarët, objekte para shembjes krejt këto t'i specifikoni.

Listën e pikave të hot-spotëve, nëse keni mungesë të punëtorëve a keni shpallë ndonjë konkurs, pastaj duhet ti keni edhe protokollet e veprimt. ne çfarë standardi veproni.

Hafir Rexha: Ne kemi sektorin e preventives ndaj zjarrit, atyre ju paguajmë pagat, rrobat por ata i përgjigjen Agjencionit.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

### 4. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2020.

Milazim Morina: Si drejtori jemi mundu me përshkrua punën tonë në këtë raport sipas detyrave të parapara. Shumë punë i kemi monitoruar në bashkëpunim me drejtorinë për Urbanizëm, natyrisht kemi has edhe në problem, kemi bërë mbjelljen e luleve, bimë disa vjeçare te varrezat e dëshmorëve. Kemi bashkëpunim edhe me Keds pasi që rrjeti në disa fshatra është i dobët.

Halil Morina: Besoj se në ndonjë mbledhje do të diskutojmë edhe kërkesat e qytetarëve sidomos për kanalizime dhe që në fund t'i fusim në buxhet.

Alban Krasniqi: A ka vazhdua këtë vit kontrata me Ekoregjionin, cili është niveli i realizueshmërisë së kontratës me Ekoregjionin dhe cilat punë i kanë realizuar pasi që parat po i marrin e shumë shërbime si kryejnë, pastaj a mundeni me siguru Projektin e deponive ilegale.

Te mirëmbajtja e lapidarëve para 10 ditësh të salla e sportit Flamuri ka qenë i shkyer e me vonë e kanë ngjitur por kjo nuk bën të ndodhë, pasi që flamujt duhet t'i ndërroni në formë periodike, pastaj për problemet me ujësjellës duhet të ftohe edhe Hidroregjioni. Ata duhet t'i kenë në mbikëqyrje kanalizimet sepse atyre kjo punë ju përket, sa i përket asaj që thae kemi mbikëqyrje në disa punë të Urbanizmit kjo s'do duhet të ju përket juve, nëse po a mundini me na treguar për cilësinë e

punimeve ku kanë kryer, ku kanë devijuar, pranimi bëhet pa kritere. A keni lëshuar ndonjë vendim ose pëlqim për dhënie në shfrytëzim të hapësirave publike.

Rrahim Morina: Qytetaret nuk guxojnë me mbet pa ujë dhe sa familje janë të kyçura në ujësjellës.

Hashim Vrenezi: Te linjat e transportit ka problem, është mirë të shikoni mundësinë ndoshta edhe të bëni presion që në mëngjes të ketë linjë të autobusëve për në Kijevë sidomos për nxënës që shkojnë atje në Shkollë

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/869 datë:04.9.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e “Kullës së Ramadan Shabanit” në Kijevë.

Alban Krasniqi: Për këtë kërkesë Drejtoria për Kulturë duhet me iniciuar kërkesën, po ashtu edhe projektin lidhur me Kullën e një veprimtari.

Rrahim Morina: Ashtu qysh Ligji për dhënie në shfrytëzim thotë kërkesat e tilla duhet kryetari mi iniciuar për Kuvend.

Halil Morina: Ne është mirë ta rekomandojmë për Kuvend, pastaj Drejtoria për Kulturë të merret me procedurat tjera.

Hashim Vrenezi: Nëse deri në mbledhje sjellin dokumentet shtesë për këtë kërkesë mundemi me dergu për Kuvend, nëse jo as unë s’jam i mendimit me dergu ne këtë formë.

Rrahim Morina: Nëse jemi me shty deri sa të sillet Projekti, kostoja financiare, statusi i pronës, kush jeni pra kjo kërkesë të shtyhet deri sa të plotësohen këto dokumente? Për ishin 4, kundër 1, abstenime s’kishte.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë:15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë:18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme.

Alban Krasniqi: Gjeodezia duhet me na sjelle informacione rreth lokacionit po ashtu edhe Drejtoria për Urbanizëm.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso- Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

9. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.03/311 datë: 01.09.2020 nga Eronit Bytyçi nga fshati Kervaseri.

Rrahim Morina: Ky ka kërkuar një Laptop, por KPF nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën në fjalë. Parashtruesit të kësaj kërkesë duhet t’i jepet një përgjigje, kush jeni lidhur me këtë kërkesë të parashtruar në KPF? Për s’kishte, kundër s’kishte, të gjithë abstenim.

Kërkesa nr.02/288 datë: 21.08.2020 nga Elsa Krasniqi nga fshati Bardh.

Valon Krasniqi: Unë këtë vajzë e njof ka kërkuar t’i ndihmohet pasi që është me kushte jo të mira ekonomike, është nxënëse e dalluar. Unë kërkoj t’i ndihmojmë se tani është regjistruar edhe në kolegjin privat pra është nxënëse me një sukses të dalluar.

Alban Krasniqi: Mos të krijojmë këso standarde të dyfishta, sepse kanë me vërshuar me kërkesa, nuk jam që kështu me kaq lehtësi t’i ndihmojmë, plus e ka prindin në Komunë i punon e dikush nuk e ka këtë mundësi hiq.

Raimonda Krasniqi: Duhet të dimë nëse kjo nxënëse sa ka pas zbritje në kolegjin privat aty ku qenka e regjistruar.

Halil Morina: Gjendjen e ekonomike se ka të mira është nxënëse e dalluar edhe nëpër gara ku janë organizuar.

Rahim Morina: Tani Alban Krasniqi dhe Raimonda Krasniqi lëshuan mbledhjen jemi prezent 4 anëtarë, kush jeni për përkrahje me 500 euro të Elsa Krasniqi? Për ishin 3, kundër 1.

Kërkesa nr.02/309 datë:01.09.2020 e para shtruar nga Libade Mazreku.

Rahim Morina: Sipas kërkesës shihet që ka pas një operacion më herët.

Hashim Vrenezi: Rastet me tomor dihet që kanë vizita edhe kohe pas kohe.

Rahim Morina: Kush jeni qe ta ndihmojmë me 500 euro? Për ishin 4 unanimisht.

Kërkesa nr.02/307 datë: 01.09.2020 e parashtruar nga z. Brahim Hoxha nga fshati Guncat.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë t'i përcillet zyrës së kryetarit të Komunës.

Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/304 datë 27.08.2020 e parashtruar nga banorët e Lagjes Shala nga fshati Mleqan. e parashtruar.

Rahim Morina: S'kem çka me trajtuar këtë kërkesë pasi që kërkesa si e tille është futur në projektet e parapara me projekt buxhetin e vitit 2021.

Kërkesa nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup.

Hashim Vrenezi: Jam me autorizuar drejtorinë për Urbanizëm të merret me këtë kërkesë.

Rahim Morina: Unë kërkoj ta rekomandojmë për Kuvend, kush jeni për? Unanimisht ishin për.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:10

Procesmbajtësi

Naim Aydiqaj jur. i dip

